


# Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, 2016

**Tiranë, 18 Qershor, 2018:** Në vitin 2016, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korente u vlerësua 1.475.251 milionë Lekë, duke shënuar një rritje në terma realë prej rreth 3,35 %, krahasuar me vitin 2015.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2016, e ka dhënë Qarku Tiranë me +1,62 pikë përqindje, pasuar nga Qarku Vlorë me + 0,44 pikë përqindje dhe Qarku Durrës me +0,39 pikë përqindje. Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë Qarku Fier me -0,50 pikë përqindje, i pasuar nga Qarku Kukës me një kontribut prej -0,04 pikë përqindje dhe Qarku Gjirokastrë me një kontribut prej +0,06 pikë përqindje.

Fig.1 Kontributi i Qarqeve në rritjen ekonomike



Sipas rajoneve statistikore në nivel 3, rritjen më të lartë e shënoi Qarku Vlorë me një rritje në terma realë prej 7,69 %, i ndjekur nga Qarku Korçë me një rritje në terma realë prej 6,20 % dhe Qarku Dibër me një rritje në terma realë prej 6,19 %.

Rritja ekonomike u ngadalësua në Qarkun Fier, duke shënuar një rënie në terma realë prej 4,22 % dhe në Qarkun Kukës me një rënie në terma realë prej 2,04 %.

**Tab. 1 PBB sipas rajoneve statistikore**

Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	PBB çmime korente (milion Lekë)	PBB çmime korente (milion Lekë)	Rritja Reale e PBB-së	Kontributi ndaj rritjes Reale	Struktura ndaj PBB-së	Struktura ndaj PBB-së
		2015*	2016**	2016**/2015*	2016**/2015*	2015*	2016**
<b>AL</b>	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>1.434.307</b>	<b>1.475.251</b>	<b>3,35</b>	<b>3,35</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	<b>337.996</b>	<b>349.612</b>	<b>4,09</b>	<b>0,96</b>	<b>23,6</b>	<b>23,7</b>
AL011	Dibër	46.850	48.595	6,19	0,20	3,3	3,3
AL012	Durrës	140.260	145.190	4,01	0,39	9,8	9,8
AL013	Kukës	26.008	25.250	-2,04	-0,04	1,8	1,7
AL014	Lezhë	47.513	50.393	6,12	0,20	3,3	3,4
AL015	Shkodër	77.364	80.184	3,81	0,21	5,4	5,4
<b>AL02</b>	<b>Qendër</b>	<b>675.935</b>	<b>699.198</b>	<b>3,92</b>	<b>1,85</b>	<b>47,1</b>	<b>47,4</b>
AL021	Elbasan	100.200	102.775	3,33	0,23	7,0	7,0
AL022	Tiranë	575.735	596.423	4,03	1,62	40,1	40,4
<b>AL03</b>	<b>Jug</b>	<b>420.376</b>	<b>426.440</b>	<b>1,84</b>	<b>0,54</b>	<b>29,3</b>	<b>28,9</b>
AL031	Berat	54.691	58.041	5,06	0,19	3,8	3,9
AL032	Fier	169.437	160.941	-4,22	-0,50	11,8	10,9
AL033	Gjirokastrë	34.309	34.936	2,49	0,06	2,4	2,4
AL034	Korçë	80.826	85.518	6,20	0,35	5,6	5,8
AL035	Vlorë	81.112	87.005	7,69	0,44	5,7	5,9

\*2015 Të dhëna Finale

\*\*2016 Të dhëna gjysmë-finale


### PBB për frymë sipas niveleve statistikore

Në vitin 2016, niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 arriti në 513 mijë Lekë. Krahasuar me vitin 2015 PBB për frymë u rrit me 3,0 %.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3, në vitin 2016, ishte në Qarkun Tiranë, me 669 mijë Lekë dhe shënoi një rritje prej 1,9 % krahasuar me vitin 2015. PBB për frymë e këtij qarku ishte 36,4 % mbi mesataren e vendit. Më pas renditet Qarku Fier, me 530 mijë Lekë, duke shënuar një rënie prej 4,2 % ndaj vitit 2015. PBB për frymë e këtij qarku ishte 3,3 % mbi mesataren e vendit.

Niveli më i ulët i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 në vitin 2016, u vlerësua në Qarkun Kukës me rreth 314 mijë Lekë duke shënuar një rënie me 1,2 %, krahasuar me vitin 2015. PBB për frymë e këtij qarku ishte 38,8 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon Qarku Elbasan me rreth 360 mijë Lekë duke shënuar një rritje me 3,8 % ndaj vitit 2015. PBB për frymë e këtij qarku ishte 29,9 % nën mesataren e vendit.

Fig.2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2016 (000/Lekë)



**Tab. 2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore**

Kodi	Niveli Statistikor 2/3	PBB për frymë (Lekë)		Indeksi ndaj PBB-së (%)	
		2015*	2016**	AI=100	AI=100
<b>AL</b>	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>497.902</b>	<b>512.934</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	<b>405.408</b>	<b>421.755</b>	<b>81,4</b>	<b>82,2</b>
AL011	Dibër	360.231	381.681	72,3	74,4
AL012	Durrës	502.551	513.921	100,9	100,2
AL013	Kukës	317.715	313.951	63,8	61,2
AL014	Lezhë	362.568	388.720	72,8	75,8
AL015	Shkodër	365.513	383.569	73,4	74,8
<b>AL02</b>	<b>Qendër</b>	<b>599.390</b>	<b>614.201</b>	<b>120,4</b>	<b>119,7</b>
AL021	Elbasan	346.548	359.712	69,6	70,1
AL022	Tiranë	686.570	699.475	137,9	136,4
<b>AL03</b>	<b>Jug</b>	<b>457.288</b>	<b>469.251</b>	<b>91,8</b>	<b>91,5</b>
AL031	Berat	399.485	434.137	80,2	84,6
AL032	Fier	552.703	529.745	111,0	103,3
AL033	Gjirokastrë	498.759	521.582	100,2	101,7
AL034	Korçë	369.389	396.148	74,2	77,2
AL035	Vlorë	430.949	461.776	86,6	90,0

\* 2015 Të dhëna Finale

\*\* 2016 Të dhëna gjysmë-finale

**Standardi i Fuqisë Blerëse**

PBB e Republikës së Shqipërisë e shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard - PPS) në vitin 2016 është 24.468 PPS.

PBB për frymë në PPS për vitin 2016 për Republikën e Shqipërisë është 29,1 % e mesatares së Bashkimit Evropian BE28 = 100 (shih shënime metodologjike). Sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin Qendër, PBB për frymë në PPS për vitin 2016 ishte 34,9 %, në rajonin Veri 24,0 % dhe në rajonin Jug 26,7 %.

**Tab.3 PBB për frymë në PPS (BE28=100)**

Kodi	Rajonet Statistikore	PBB për frymë në PPS (BE28=100) në 2016
	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>29,1</b>
	<b>Rajone Statistikore Nivel 2</b>	
AL01	Veri	24,0
AL02	Qendër	34,9
AL03	Jug	26,7

**Tab. 4 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Dega = 100%), viti 2016\*\***

Kodi	Nivelet Statistike 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivite të pasurive të paluajtshme	Aktivite shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
<b>AL</b>	<b>Republika e Shqipërisë</b>	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	<b>29,3</b>	<b>29,0</b>	<b>23,6</b>	<b>22,9</b>	<b>15,0</b>	<b>16,3</b>	<b>24,6</b>	<b>12,8</b>	<b>20,8</b>	<b>13,5</b>	<b>23,7</b>
AL011	Dibër	6,2	5,8	1,4	1,4	1,7	1,8	1,5	0,5	3,2	0,8	3,3
AL012	Durrës	7,7	12,6	11,2	13,5	5,2	5,6	13,9	7,8	6,4	5,9	9,8
AL013	Kukës	3,2	1,9	0,8	0,7	1,4	1,3	1,0	0,6	2,3	1,2	1,7
AL014	Lezhë	4,9	2,2	5,7	2,8	1,8	3,5	3,1	1,1	3,3	2,1	3,4
AL015	Shkodër	7,4	6,5	4,5	4,4	4,9	4,1	5,1	2,8	5,6	3,6	5,4
<b>AL02</b>	<b>Qendër</b>	<b>20,2</b>	<b>41,2</b>	<b>54,1</b>	<b>52,8</b>	<b>71,2</b>	<b>59,8</b>	<b>53,3</b>	<b>77,0</b>	<b>56,8</b>	<b>69,6</b>	<b>47,4</b>
L021	Elbasan	12,6	7,3	4,6	5,0	4,2	4,9	5,5	2,0	6,6	3,8	7,0
AL022	Tiranë	7,6	33,9	49,5	47,8	67,0	54,9	47,8	75,0	50,2	65,8	40,4
<b>AL03</b>	<b>Jug</b>	<b>50,5</b>	<b>29,8</b>	<b>22,4</b>	<b>24,4</b>	<b>13,8</b>	<b>23,9</b>	<b>22,1</b>	<b>10,2</b>	<b>22,5</b>	<b>16,9</b>	<b>28,9</b>
AL031	Berat	8,6	3,6	3,0	2,2	2,3	1,9	1,9	0,9	3,2	1,8	3,9
AL032	Fier	21,5	13,5	7,1	8,1	3,3	7,9	6,9	4,7	6,1	3,5	10,9
AL033	Gjirokastrë	3,3	1,9	1,9	2,7	2,1	3,0	1,6	0,7	2,6	1,7	2,4
AL034	Korçë	10,5	3,8	4,2	5,1	3,4	5,4	4,3	1,5	5,5	6,0	5,8
AL035	Vlorë	6,6	7,0	6,0	6,3	2,8	5,6	7,4	2,4	5,1	3,9	5,9

\*\*2016 Të dhëna gjysmë-finale


Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

**Tab. 5 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Rajoni = 100%), viti 2016\*\***

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
AL	<b>Republika e Shqipërisë</b>	22,7	13,9	10,2	18,1	3,5	2,8	6,6	6,7	12,5	3,0	100,0
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	28,1	17,0	10,1	17,5	2,2	1,9	6,9	3,6	10,9	1,7	100,0
AL011	Dibër	42,9	24,7	4,3	7,9	1,8	1,5	3,0	1,1	12,0	0,7	100,0
AL012	Durrës	17,8	17,9	11,6	24,8	1,9	1,6	9,4	5,3	8,1	1,8	100,0
AL013	Kukës	41,9	15,2	4,7	7,9	2,8	2,1	3,9	2,2	17,1	2,0	100,0
AL014	Lezhë	32,3	8,8	17,1	15,1	1,8	2,8	6,0	2,2	12,1	1,8	100,0
AL015	Shkodër	30,8	16,6	8,3	14,6	3,2	2,1	6,2	3,4	12,8	2,0	100,0
AL02	Qendër	9,7	12,1	11,6	20,2	5,3	3,5	7,5	10,8	15,0	4,4	100,0
AL021	Elbasan	41,0	14,6	6,7	13,1	2,1	1,9	5,2	1,9	11,8	1,6	100,0
AL022	Tiranë	4,3	11,6	12,5	21,4	5,8	3,8	7,8	12,4	15,5	4,9	100,0
AL03	Jug	39,6	14,3	7,9	15,3	1,7	2,3	5,1	2,4	9,7	1,8	100,0
AL031	Berat	49,6	12,9	7,9	10,1	2,1	1,4	3,1	1,5	10,2	1,4	100,0
AL032	Fier	44,7	17,2	6,7	13,4	1,1	2,0	4,2	2,9	7,0	1,0	100,0
AL033	Gjirokastrë	31,4	10,9	8,4	20,3	3,1	3,5	4,5	1,9	13,9	2,2	100,0
AL034	Korçë	41,1	9,2	7,5	16,0	2,0	2,6	5,0	1,8	11,8	3,1	100,0
AL035	Vlorë	25,5	16,5	10,3	19,4	1,7	2,6	8,4	2,7	10,8	2,0	100,0


\*\*2016 Të dhëna gjysmë-finale

Fig.3 PBB për frymë sipas Qarqeve



NUTS 2  
 Qark

PBB për frymë në mijë Lekë




Shqipëria 513

\* Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore nivelit 2 dhe 12 rajone statistikore nivelit 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KMM nr.1037 datë 16.12.2010,  
 \*\*Mbi implementimin e Nomenklaturës NUTS<sup>2</sup> duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian<sup>2</sup>

Shënim: Kufijtë administrativë janë arritur për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësisë lokale.

Fig. 4 PBB me çmime korente sipas Qarqeve



NUTS 2  
 Qark

PBB në miliardë Lekë

201 - 600  
 101 - 200  
 51 - 100  
 41 - 50  
 25 - 40

\* Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore nivel 2 dhe 12 rajone statistikore nivel 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të K/M nr.1037 datë 16.12.2010, "Mbi implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Teritoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"

Shënim: Kufijtë administrativë janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësive lokale.



# Shënime Metodologjike

Ky publikim paraqet rezultatet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2016 në Republikën e Shqipërisë sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, si dhe degëve të ekonomisë sipas nomenklaturës NVE Rev2.

Llogaritë Kombëtare Rajonale bazohen në metodologjinë ESA 2010, kryesisht te Kapitulli 13, duke marrë si bazë vlerësimet më të fundit të Llogarive Kombëtare Vjetore të publikuara më 3 Prill 2018, në mënyre që të ruhet konsistenca e këtyre treguesve.

Informacioni më i detajuar rreth Llogarive Kombëtare Rajonale (2011-2016) mbi treguesit rajonalë mund ta gjeni në linkun më poshtë.

<http://www.instat.gov.al/al/themes/llogarit%C3%AB-kombetare.aspx?tab=tabs-5> Linkun me tabelat në Excel.

## Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e treguesve rajonalë mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare rajonale. Përditësimet e klasifikimeve bëhen që treguesit ekonomikë rajonalë të jenë më të dobishëm për përdoruesit, në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe të përmirësojnë krahasueshmërinë e të dhënave midis rajoneve dhe vendeve anëtare të BE-së bazuar në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian.

## Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente, pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Ndryshimet në vlerësimet e Llogarive Kombëtare Vjetore kanë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji. INSTAT ka bërë një ndryshim cilësor në zhvillimin e metodave në vlerësimin e VSHB-së rajonale për ndarjen e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë kryesore në një apo më shumë rajone.

Në lidhje me metodologjinë e përdorur konsultohuni me materialin: “Metodologjia e Llogarive Rajonale në Shqipëri” në adresën e mëposhtëme: [http://www.instat.gov.al/media/251599/manual\\_metodologjik.pdf](http://www.instat.gov.al/media/251599/manual_metodologjik.pdf)

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare Rajonale janë:

- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

**Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat (NUTS)** është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbliidhen dhe përpunohen, statistikat rajonale evropiane.

**Standarti i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard-PPS)** është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatet (treguesit) vlerësuar me çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit i PBB-së për frymë i shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse (PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e Bashkimit Evropian (BE28=100).

Ju lutem vini re se indeksi i shprehur në PPS përdoret për krahasime midis vendeve sesa për krahasime në termat e serive kohore. Për informacione të mëtejshme mbi koeficientët e PPS ndiqni adresën e mëposhtme: <http://ec.europa.eu/eurostat/web/purchasing-power-parities/data/database>